

Elza Shipoli

Instituti Albanologjik
Prishtinë

XHAMIA E HASAN PASHË GJAKOVALISË NË PÉCS TË HUNGARISË

Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër: Periudha e Perandorisë Osmane solli me vete ndryshime në shumë aspekte kulturore, sociale, juridike dhe ekonomike. Kjo periudhë pati rëndësi të madhe për shumë qytete të Evropës në përgjithësi, duke përfshirë edhe Hungarinë në veçanti. Shumë shqiptarë zunë poste të rëndësishme në Perandorinë Osmane, ndër ta edhe Hasan Pashë Gjakovalia, i cili vepronte në Pécs të Hungarisë. Ndikimi i tij për kohën sa vepronte në këtë vend la gjurmë të pashlyeshme në udhëheqësi, por edhe në investimet e tij. Këtu po e përmendim ndërtimin e kompleksit të ndërtesave, që përfshinte një xhami, një medrese dhe një manastir. Xhamia e Hasan Pashë Gjakovalisë edhe sot, fatmirësisht, është njëra ndër xhamitë që i ka mbijetuar kohës. Historia e kompleksit e veçanërisht xhamia në fjalë, duke pasur parasysh vjetërsinë, origjinalitetin dhe historinë e saj, ka arritur që si monument të mbrohet nga shteti dhe të jetë muze i qytetit. Ky punim përshkruan arsyen e ndërtimit të kompleksit, prejardhjen e Hasan Pashë Gjakovalisë, si dhe xhaminë e cila për kaq shumë dekada i ka rezistuar kohës.

Fjalët kyqe: *Hasan Pashë Gjakovalia, Pécs, Hungari, kompleks, xhami, Periudha Osmane.*

Kush ishte Hasan Pashë Gjakovalia?

Hasan Pashë Gjakovalia ishte ndër figurat e shquara të Perandorisë Osmane në Hungari. Mbi origjinën e Hasan Pashë Gjakovalisë ka dy teori, të cilat edhe sot ngrenë shumë pikëpyetje sidomos te studiuesit ndërkombëtarë. Deri tani janë shkruar shumë artikuj të ndryshëm, të cilët e shpërfillin apo edhe devijojnë origjinën e Hasan Pashë Gjakovalisë si dhe e lidhin prejardhjen e tij me vendin e quajtur Đakovo në Kroaci dhe shumë rrallë me Gjakovën në Kosovë.

Hasan Pashë Gjakovalia ishte i pari i Kryezinjve që u ngjit në hierarkinë politike osmane. Ai, që nga viti 1649, kur u bë bejlerbej i Bosnjës, e deri në vitin 1694 kur, si mytesarifit të Shkodrës, fuqinë më të madhe ekonomike dhe famën i arriti në Hungari, me themelimin e një kompleksi vakëfesh, që përbëhet nga një xhami (që edhe sot qëndron), një medrese dhe një mevlevihane¹.

Sipas kronikës osmane të Ibrahim Peçeviut, Memi Beu ishte me origjinë shqiptare². Ai mori pjesë në fushatat e Gazi Hüsrev, sanxhaku boshnjak, në gjysmën e parë të shekullit XVI dhe atij iu besua shënimi i

kufijve të Sanxhakut Lika (Krka), i cili u krijua pak para vitit 1580³. Evlija Çelebiu në thelb e pohon të njëjtën gjë, Memi Beun e përmend me nofkën Arnavud Memi⁴.




Fig.1. Qyteti i Pécsit në shekullin XVII. 1. Kalaja. 2. Xhamia. 3. Kisha e të gjithë Shenjtorëve. 4. Shkolla. 5. Xhamia e Hasan Pashë Gjakovalisë. 6. Xhamia. (E.Foerk 2016).

¹ KRASNIQI (2018:1232).

² PEÇEVI (1866: 194).

³ ZAHIROVIĆ (2012:124).

⁴ SUDÁR (2006: 33).

Në disa letra familjare të ruajtura, me shumë gjasë rreth vitit 1631, thuhet se Hasani shkoi në Stamboll për të marrë leje për të bërë pelegrinazh në Mekë, meqenëse më vonë shfaqet në disa raste edhe me termin haxhi⁵. Kompleksi i Hasan Pashë Gjakovalisë me shumë gjasë ishte gati në vitin 1663⁶.

Marrë parasysh faktin që Hasan Pashë Gjakovalia ndërtoi një kompleks të tërë jashtë portës *Sziget* (fig.1), sigurisht që ishte i lidhur me qytetin e Pécs-it, sepse një nga të afërmit e tij, në këtë rast gjyshi i tij⁷, Memi Pasha ndërtoi kompleksin e tij brenda portës, dhe për gjë që Hasan Pashë Gjakovalia dëshironte që themelet e familjes së tij t'i mbante në një bllok⁸.

Xhamia e Hasan Pashë Gjakovalisë

Vizita ime në qytetin e Pécs-it, në prill të vitit 2023, më shtyu që të shkoja në xhami e të shihja se çfarë ka mbijetuar deri në ditët e sotme dhe ajo që kishte mbijetuar i kaloi pritshmëritë e mija.

Hyrja në oborrin e xhamisë të jepte një përshtypje të përjetimit të ndjesisë së periudhës osmane në Pécs. Marrë parasysh faktin që xhamia kishte kaluar disa faza restaurimi, sot, pas më shumë se 300 viteve, nga jashtë dukej në gjendje mjaft të mirë (fig.2).



Fig. 2. Xhamia e Hasan Pashë Gjakovalisë (E.Shipoli)

⁵ HANCZ – VARGA (2013: 43).

⁶ HANCZ – VARGA (2013: 43).

⁷ GUIDA E MUZEUT TË PÉCS, JAKOVALI HASAN PASHA MOSQUE AND MUSEUM 2.

⁸ HANCZ – VARGA (2013: 44).

Ngjitur me objektin e klinikës oftalmike, që në tërësi xhamia është e rrethuar nga disa klinika shëndetësore të spitalit të qytetit, zë vendin pikërisht në zemrën e qytetit të Pécsit.

Sot xhamia shërben si muze dhe në të njëjtën kohë si kult fetar. Në hyrje kishte një video-prezantim sa i përket dervishëve, pastaj kishte ekspozitën e përhershme, që është hap në vitin 2022, e që sjellë edhe magjinë e “*Sallës së shqisave*”, një muze me artefakte që kishin ngjashmëri të periudhës osmane dhe orientit⁹. Korridori që shpinte direkt në xhami kishte fotografi dhe video-incizime të ndryshme, që e prezantonin Pécs-in në periudhën osmane e ku fokusi ishte gjithnjë në Xhaminë e Gjakovali Hasan Pashës.

Sa i përket vet qyteti, t gjatë periudhës osmane, u bë shpejt një qendër tregtare e veçantë orientale me pazare të mëdha, gjithashtu u rrit në një qytet multietnik dhe multifunksional¹⁰.

Konstruksioni i xhamisë së Hasan Pashë Gjakovalisë është ndërtuar jashtë mureve perëndimore të qytetit, pranë portës *Sziget*, jo shumë larg xhamisë së Memi Pashës, që ndodhej brenda qytetit, ndërsa rrënojat e hamamit mund të shihen edhe sot. Vakëfi i Hasan Pashë Gjakovalisë në shekullin XVII përfshinte: xhaminë aktuale, një manastir të dervishëve mevlevi, një shkollë fetare, një kuzhinë për të varfrit dhe udhëtarët, kopshtin dhe varrezat¹¹.

⁹ NEMZETI ÖRÖKSÉGVÉDELMI FEJLESZTÉSI NONPROFIT KFT. | NÖF. (N.D.). *PÉCS - TÜRBE*. [Online] E Disponueshme: <https://Nof.Hu/En/Pecs-Turbe/> [Qasur më: 21.06.2024].

¹⁰ GUIDA E MUZEUT TE PECS, JAKOVALI HASZAN PASHA MOSQUE AND MUSEUM, 1-2.

¹¹ GUIDA E MUZEUT TE PECS, JAKOVALI HASZAN PASHA MOSQUE AND MUSEUM, 1-2.




Fig. 3. Xhamia gjatë restaurimit të kupolës

Në gjysmën e dytë të shekullit XVIII xhamia u shndërrua në një kishëz, me urdhrin e peshkopit Nesselrode¹².

Restaurimi historik dhe gjermimi i detajeve arkitekturore osmane u kryen midis viteve 1955 dhe 1961, kur ndërtesa mori formën që e ka edhe sot (fig.3)¹³.

Përshkrimi i Xhamisë së Hasan Pashë Gjakovalisë

Hyrja në xhami ndodhet pas kalimit të korridorit të gjatë ndërlidhës së xhamisë dhe ekspozitës - *Sallës së shqisave*.

Dera është nga materiali i drurit dhe sipër saj ka gravim në formë gjysmërrethore. Në të gjendet një dekorim në formë trekëndëshi që kap mesin e gravimit gjysmërrethor dhe bie deri tek pjesa e sipërme e derës me dekorim *mukarnas* (fig.4), në pjesën e brendshme të së cilës gjendet një shkrim në gjuhën arabe. Hyrja e saj e vjetër, një portë me hark, ishte në gjysmën jugore të murit perëndimor, por më vonë u muros¹⁴.

¹² DERCSÉNYI – POGÁNY – SZENTKIRÁLYI (1956:214).

¹³ NEMZETI ÖRÖKSÉGVÉDELMI FEJLESZTÉSI NONPROFIT KFT. | NÖF. (N.D.). *PÉCS - TÜRBE*. [Online] E Disponueshme: <https://nof.hu/en/pecs-turbe/> [Qasur më: 21.06. 2024].

¹⁴ FOERK (2016: 20).



Fig.4. Porta e xhamisë (E.Shipoli)



Fig. 5. Pjesa e brendshme e xhamisë, mihrabi dhe minberi (E.Shipoli)

Përballë hyrjes në xhami kemi *mihrabin* (fig.5), i cili po ashtu ka dekorim tipik *mukarnas* të theksuar, afër saj në anën e djathtë kemi *minberin*, në anën e majtë të hyrjes kemi një model të xhamisë në miniaturë (fig.6).

Hapësira e xhamisë është një hapësirë e vetme në formë katrore (fig. 7), mbi të cilën ngrihet një kupolë tetëkëndëshe me kalim *mukarnas*¹⁵.

Pjesa e brendshme e xhamisë ndahej me kamare murore në disa vende, me zbukurime bimore të pikturuara polikrome me mbishkrime kaligrafike të citimeve nga Kurani¹⁶ (fig.8). Në cepat e mureve të xhamisë kemi dekorim *mukarnas*, dekorim i cili gjithashtu paraqitet edhe tek pjesët e fillimit të qemerëve.

¹⁵ DERCSÉNYI – POGÁNY - SZENTKIRÁLYI (1956:214).

¹⁶ GERŐ (1980: 119).



Fig. 6. *Xhamia miniaturë* (E.Shipoli)




Fig. 7. *Planimetria e xhamisë* (G. Geró 1980)

Në tërësi xhamia ka gjashtë dritare te niveli i parë, ku sipër tyre janë dy qemerë më të mëdhenj në dy dritaret e dy anëve: të djathtë dhe të majtë. Ndërsa në dritaret përballë hyrjes dhe anash tyre kemi pesë qemerë të tjerë, nga të cilët katër janë të vendosur mbi dritare dhe një mbi *mihrab*, tre prej këtyre qemerëve kanë dritare.

Qemerët përbëjnë të njëjtin dizajn pikturimi dhe gjithashtu janë dy llojesh të ngjyrave - të kuqë dhe të zinj. Brenda xhamisë gjendet mbetje e pikturuar *tughra* e Hasan Pashë Gjakovalisë¹⁷.

Dyshemeja ka një ndërhyrje të vonshme të vendosur në mes të xhamisë; përballë *mihrabit* është i vendosur një gur i gdhendur me dekorim në formë kryqi, që dallon shumë nga materiali origjinal i dyshemesë (fig.9). Kupola në pjesën e brendshme është në gjendje jo mjaft të mirë për shkak të lagështisë që e kishte mbuluar (fig. 10), mirëpo ende shihet pikturimi polikrom i diametrit të saj.

¹⁷ GERÓ (1976: 17).




Fig. 8. Kaligrafi me citime të Kuranit
(E.Shipoli)



Fig.9. Dyshemeja me ndërhyrje
të një guri me gdhendje kryqi
(E.Shipoli)



Fig. 9 Pikturimi polikrom i diametrit të kupolës dhe dëmtimet e saj nga lagështia (E.Shipoli, prill 2023)

Pjesa e jashtme e Xhamisë

Sa i përket pjesës së jashtme të Xhamisë, ajo ka oborrin dhe varrezat, është e vendosur në një ndërlidhje me gjithë strukturën e oborrit të spitalit të Pécs-it.

Peshkopi Nesselrode e zëvendësoi kupolën e xhamisë origjinale, që fillimisht ishte nga materiali i plumbit¹⁸, me atë të stilit barok në formë qepe¹⁹. Kupola e ngjashme me originalin u vendos në vitin 1890, kur u restaurua²⁰.

Struktura e pjesës së poshtme të ndërtimit të xhamisë ka gurë të mëdhenj ashlar në formë drejtkëndore të cilat janë një bazë e fortë e saj (fig.10). Çfarë vërehet qartë nga disa prej fotografive është edhe pjesa e fasadës, që ka disa ndërhyrje, sidomos muri në të cilin është hyrja e xhamisë ka disa tulla të shtuara dhe shihen ndërhyrjet që në pjesën afër minares (fig.11).



Fig. 10. *Struktura e pjesës së poshtme të xhamisë e punuar me gurë të mëdhenj ashlar*
(E.Shipoli)



Fig. 11. *Ndërhyrjet me tulla në pjesën e murit dhe të minares*
(E.Shipoli)

¹⁸ SZÖNYI (1925: 84).

¹⁹ DERCSÉNYI – POGÁNY - SZENTKIRÁLYI (1956:214).

²⁰ SZÖNYI (1925: 84).

Minarja është e ndërtuar me gurë të vegjël ashlar dhe bashkohet me trupin e xhamisë në cepin veriperëndimor të ndërtesës.²¹ Minarja (fig.12) qëndron në këndin veriperëndimor të murit perëndimor, është dymbëdhjetëkëndëshe, me lartësi totale prej 25 metrash²².




Fig. 12. Detaje nga minarja (E.Foerk 2016).

Ballkoni dikur ishte i zbukuruar me kangjella guri, ndezur me llamba vaji në festat fetare²³. Parvazi katror që rrethon bazamentin e minares dhe vija ndarëse formohet nga një unazë me një seksion kryqi gjysmërrethor, të njëjtën e gjejmë edhe te minarja e Xhamisë Sulltan Mehmet Fatihut (Xhamia e Madhe) në Prishtinë.²⁴

Në oborr gjenden edhe disa varreza të periudhës osmane, të vendosura në pjesën e hyrjes origjinale të xhamisë (fig.13), ndërsa në pjesën e hyrjes moderne gjendet statuja e historianit të shekujve XVI-XVII, Ibrahim Peçevisë (fig.14).

²¹ GERÓ (1980: 54).

²² FOERK (2016: 20).

²³ HANCZ – VARGA (2013: 46)

²⁴ GERÓ (1980: 71).

Sipas fjalëve të Evlia Celebiut për xhaminë e Hasan Pashë Gjakovalisë: “Edhe ky është një vend i bukur, me varrezë të vjetër, dhe ndërtesë të madhe, edhe ky është një vend i zbukuruar lutjesh i mbuluar me kupolë blu plumbi. Minarja e saj është pika kryesore e arkitekturës së vjetër, proporcionale dhe tërheqëse të traditës muhamediane”²⁵.



Fig. 13. Varrezat në oborrin e xhamisë (E. Shipoli)



Fig. 14. Statuja e historianit Ibrahim Peçevi (E.Shipoli)




Fig. 15 Marrë nga Gazeta hungareze Varsánapi Ujság: Ilustrim i xhamisë, viti 1855



Fig. 16 Varsánapi Ujság: Xhamia e Hasan Pashë Gjakovalisë, 1866

²⁵ HANCZ – VARGA (2013: 47)




Fig. 17. Detaje nga planimetria e brendshme e xhamisë me detaje dekoruese (E. Foerk, 2016)

PËRFUNDIM

Xhamia e Hasan Pashë Gjakoalisë është një ndër objektet e kultit më të ruajtura gjatë Perandorisë Osmane në Hungari. Ajo se çfarë vlen të theksohet është fakti që është e vetmja xhami në tërë Hungarinë që e ka strukturën e planit të xhamisë së plotë, të ruajtur mirë, marrë parasysh faktin që të gjitha xhamitë në Hungari ose nuk kanë fare minare apo e kanë minaren të ndërtuar deri në gjysmë, siç është rasti i xhamisë në Esztergom, apo ka vetëm minare dhe pa objekt të xhamisë, ndërsa Xhamia e Hasan Pashë Gjakoalisë është e vetmja me minare dhe objekt të plotë, të ruajtur deri në ditët e sotme në Hungari.

Ky monument kulti është një dëshmi që udhëheqësit me prejardhje shqiptare kanë ndërtuar jo vetëm xhami, por edhe komplekse të tëra vakëfesh gjatë shekujve XVI-XVII në Evropë dhe me gjerë, ku dhe sot janë të ruajtura si monumente kulturore, fetare, trashëgimore dhe të mbrojtura nga shteti në vendet përkatëse.

BIBLIOGRAFIA

- DERCSÉNYI – POGÁNY – SZENTKIRÁLYI 1956 D. DERCSÉNYI – F. POGÁNY – Z. SZENTKIRÁLYI: *Pécs. Városképek - Műemlékek sorozat.* Műszaki, Budapest, 1956.
- FOERK 2016 E. FOERK: *Török emlékek Magyarországon,* Budapest, 2016.
- GERŐ 1976 G. GERŐ: *Török építészeti emlékek Magyarországon,* Budapest, 1976.
- GERŐ 1980 G. GERŐ: *Az oszmán-török építészet Magyarországon: Dzsámik, türbék, fürdők.* Művészettörténeti füzetek (12). Akadémiai Kiadó, Budapest. 1980.
- GMP GUIDA E MUZEUT TË PËCS-IT. *Jakovali Haszan Pasha Mosque and Museum, n.d.*
- HANCZ – VARGA 2013 E. HANCZ – S. VARGA: *Pécs mindennapjai a török félföld alatt.* Pannon Kultúra Alapítvány – Janus Pannonius Múzeum, Pécs, 2013.
- KRASNIQI 2018 N. KRASNIQI: *Oxhaku i Kryezinjve,* Fjalori Enciklopedik i Kosovës, II L-ZH, ASHAK, 2018.
- PEÇEVI 1866 I. PEÇEVI: *Tarih i Pecevi,* Vol. 2. Robarts- University of Toronto, 1866.
- SZŐNYI 1925 O. SZŐNYI: *Pécs - Útmutató a városban, a környéken és a Mecsekben.,* Danubia, 1925.

SUDÁR 2006

B. SUDAR: *Ki volt Jakováli Haszan Pasa?* Terebess.hu, 2006.

ZAHIROVIĆ 2012

N. ZAHIROVIĆ: *A Memibégovicsok Magyarországon, Szlavóniában és Horvátországban a 17. század első felében.* Korall nr. 48, Budapest 2012.

THE MOSQUE OF HASAN PASHA GJAKOVALIA IN PÉCS OF HUNGARY

Summary

The period of the Ottoman Empire brought significant changes across various cultural, social, legal, and economic dimensions. This period was particularly important for many cities in Europe in general, including Hungary in particular.

Many Albanians held significant positions within the Ottoman Empire, including Hasan Pasha Gjakovalia, who operated in Pécs, Hungary. His influence during his tenure in this region left an indelible mark on leadership, including in his investments. Notably, he is recognized for the construction of a compound that included a mosque, a madrasa, and a monastery. Fortunately, the mosque built by Hasan Pasha Gjakovalia remains one of the few that has withstood the test of time.

The history of the compound, particularly of the mosque in question, considering its antiquity, originality, and historical significance, has led to its protection as a monument by the state, allowing it to serve as a museum for the city.

This paper outlines the rationale behind the construction of the compound, the origin of Hasan Pasha Gjakovalia, and the mosque that has withstood the test of time for so many decades.

Keywords: *Hasan Pasha Gjakovalia, Pécs, Hungary, compound, mosque, Ottoman period.*

